

AKTI THEMELTAR DHE STATUTI **SHOQERISE "MSP Trade Concept"**

Shoqeria me ortak te vetem Z.Adrian Dizdari ne aktivitetin e saj vepron ne zbatim te Ligjit Nr.7632, date 4.11.1992 "Per dispozitat qe rregullojne pjesen e pare te kodit tregtar," Ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare," Ligjit Nr.7594, date 4.8.1992 "Per investimet e huaja" dhe ne kuader te Legjislacionit shqiptar.

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Emertimi i shoqerise

Neni 1

"MSP Trade Concept" SHPK, me ortak te vetem Z.Adrian Dizdari, me kapital fillestar 600,000 (gjashteqind mije) leke ose 6,000(gjashteqind mije) USD, eshte emertimi i shoqerise.

Kohezgjatja

Neni 2

"MSP Trade Concept" SHPK me ortak te vetem Z.Adrian Dizdari, e ka fiksuar aktivitetin e saj per nje periudhe 20 vjecare qe nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar.

Objekti

Neni 3

"MSP Trade Concept" SHPK me ortak te vetem Z.Adrian Dizdari, ka si objekt aktiviteti:

1. Prodhimin dhe tregtimin e konfeksioneve ne pergjithesi per burra, gra dhe femije, ne stofra natyrore ose sintetike, lekure ose te ngjashme, brenda dhe jashte vendit;
2. Prodhimin dhe tregtimin e kepuceve brenda dhe jashte vendit;
3. Import-eksportin e tapeteve te ndryshme;
4. Prodhimin e tekstileve per veshje te mendafshhta ne metrazhe ose te konfeksionuara si dhe tregtimin e tyre brenda dhe jashte vendit;

5. Kryerjen e operacioneve financiare te kembimit;
6. Hapjen e agjensive brenda vendit.

Selia

Neni 4

"MSP Trade Concept" SHPK, me ortak te vetem Z.Adrian Dizdari, aktivitetin e saj tregtar do ta realizoje ne ambientet e marra me qira nga Ndermarrja Shteterore Prodhimit Veshjeve Nr.2(NPV 2) me adrese: Rruga "Aleksander Goga" - Durres.

Personaliteti juridik

Neni 5

"MSP Trade Concept" SHPK, me ortak te vetem Z.Adrian Dizdari e fiton personalitetin e saj juridik qe nga momenti i regjistrimit ne regjistrin tregtar dhe ne organin tatimor perkates, per te ushtruar aktivitetin e saj.

Kapitali

Neni 6

Ortaku i vetem Z.Adrian Dizdari ka te drejte te transferoje pjeserisht ose teresisht kapitalin themeltar te "MSP Trade Concept" SHPK nje ose disa personave vendes apo te huaj, duke vertetuar transferimin me aktin noterial perkates.

Neni 7

Zmadhimi i kapitalit themeltar te "MSP Trade Concept" SHPK me ortak te vetem Z.Adrian Dizdari behet nepermjet kontributeve me fonde ne para dhe ne natyre. Zmadhimi i kapitalit themeltar parashikohet deri ne 68,600,000(gjashtedhjetë e tete milion e gjashteqind mije)leke ose 686,000(gjashteqind e tetedhjetë e gjashtemije)USD.

Neni 8

Zvogelimi i kapitalit themeltar te "MSP Trade Concept" SHPK, me ortak te vetem Z.Adrian Dizdari, behet vetem ne rastet e motivuara dhe te vertetuara nga humbjet.

Administrimi

Neni 9

Ortaku i vetem Z.Adrian Dizdari, lindur ne Tirane me 14.5.1959 me banim ne adresen: Blloku "50 Vjetori," Pall. 2, Shkalla 4, Apartamenti 29, eshte

administrator i vetem i aktivitetit te "MSP Trade Concept" SHPK.

Neni 10

Ortaku i vetem dhe adminstratori i "MSP Trade Concept"SHPK Z.Adrian Dizdari cakton nje perfaqshues vendas ose te huaj, i cili mund te veproje me te njejtat te drejta me ortakun e vetem dhe administratorin Z.Adrian Dizdari, vetem duke e vertetuar perfaqsimin me aktin noterial perkates.

Neni 11

Ortaku i vetem dhe administratori i "MSP Trade Concept"SHPK Z.Adrian Dizdari ose perfaqshuesi i tij sipas aktit noterial, organizojne dhe drejtojne:

- te gjithë aktivitetin e shoqerise
- administrimin e pasurive
- kontrollin
- perfaqsojne shoqerine perpara te treteve, ne gjykate dhe arbitrazh per te gjitha ceshtjet qe rezultojne gjate aktivitetit sipas objektit te percaktuar ne kete statut.

Viti financiar

Neni 12

"MSP Trade Concept"SHPK me ortak te vetem dhe administrator Z.Adrian Dizdari aktivitetin ekonomiko-financiar e dokumenton ne mbeshtetje dhe zbatim te Ligjit Nr.7661, date 19.1.1993 "Per kontabilitetin" dhe udhezimet te Ministrise Financave dhe Ekonomise.

Eksperti kontabel

Neni 13

Ortaku i vetem dhe administratori i "MSP Trade Concept"SHPK Z.ADrian Dizdari cakton nje ekspert kontabel te autorizuar prej tij per nje periudhe deri 6 vjet, por jo ne kundershtim me nenet 168 dhe 169 te Ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare."

Rezerva

Neni 14

"MSP Trade Concept"SHPK, me ortak te vetem dhe adminstrator Z.Adrian Dizdari krijon nje fond rezerve te domosdoshem nga fitimi i realizuar, mbasi ka zbritur humbjet e realizuara nga viti kaluar(nese do te kete te tilla) ne nje mase jo me te vogel se sa 1/20 e fitimit te realizuar.

Shnderrimi i shoqerise

Neni 15

"MSP Trade Concept" SHPK, me ortak te vetem dhe administrator Z.Adrian

Dizdari shnderrohet ne forma te tjera te shoqerive sipas Ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" vetem me miratimin e ortakut te vetem dhe administrator Z.Adrian Dizdari ose perfaqsesit te tij te vetem sipas aktit noterial.

Likuidimi i shoqerise

Neni 16

"MSP Trade Concept"SHPK me ortak te vetem dhe adminstrator Z.Adrian Dizdari, per arsye te ndryshme, rezulton me humbje, atehere behet likuidimi i shoqerise duke filluar me likuidimin ndaj te treteve dhe shtetit per periudhen perkatese te aktivitetit deri ne likuidimin perfundimtar.

DISPOZITA KALIMTARE

Neni 17

Emertimi dhe statuti i "MSP Trade Concept"SHPK me ortak te vetem dhe adminstrator Z.Adrian Dizdari ndryshon ne perkatesi me ndryshimet e mundshme te Legjislacionit shqiptar, me ndryshimin e aktivitetit pjeserisht ose teresisht, gjithnje sipas miratimit te ortakut te vetem dhe administratorit Z.Adrian Dizdari ose perfaqsesit te tij sipas aktit noterial.

Ortaku i vetem dhe Administratori
"MSP Trade Concept"SHPK

Adrian Dizdari



Durres,me _____ 1993